

RAPORTI I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT NË MJEDIS



Për kompaninë : “Doni-Beton” SH.P.K

Titulli i Projektit : Bazë për prodhimin e betonit

Ngastra kadastrale : P-71813064-01223-2

Zona Kadastrale : Piranë

Komuna : Prizren

Aplikuesi i Projektit: z. Naser Elshani drejtor i kompanisë “Doni-Beton” SH.P.K

Qershor, 2025

Aplikuesi:

Kompania “Doni-Beton” Sh.p.k.
Drejtor z. Naser Elshani

Adresa:

Piranë – Prizren p.n.

Tel.: +383 44 111 772

+383 44 410 262

E-mail: doni-beton@gmail.com

Hartuesi i raportit:

Dr.sc. Edona Kabashi - Kastrati

Eksperte e licencuar për VNM

Nr. Licencës së lëshuar nga MMPHI:
70/17

Adresa:

Rr. Holger Petersen p.n.

Lagja Prishtina e Re

Prishtinë, Kosovë

Tel.: +383 49 655 661

E-mail: edonak88@gmail.com

Kompania “Doni-Beton” Sh.p.k.

z. Naser Elshani, drejtor

Hartuese e Raportit:

Dr.sc. Edona Kabashi-Kastrati

v.v.

PËRMBAJTJA

1. HYRJE.....	5
2. BAZA LIGJORE E PËRPILIMIT TË RAPORTIT TË VNM-së.....	6
2.1. Rregullativa Ligjore	6
2.2. Metodologjia e Punës.....	7
3.0. PËRSHKRIMI I LOKACIONIT DHE MJEDISIT	8
3.1. Potencialet ekzistuese.....	8
3.3. Pozita gjeografike e lokacionit	10
3.2. Popullata dhe Vendbanimet.....	13
3.3. Infrastruktura ekzistuese.....	14
3.4. Kushtet klimatike	14
3.5. Erërat	15
3.6. Relievi	15
3.7. Hidrogjeologjia.....	15
3.8. Ndërtimi gjeologjik i vendburimit (Përfshirë një hartë gjeologjike të rajonit)	16
3.8.1 Kreta e Sipërme (K2.2).....	16
3.8.2 Plioceni (Pl 3).....	17
3.8.3 Kuaternari (Q)	17
3.8.4 Harta Gjeologjike e Rajonit për Kompaninë Doni-Beton sh.p.k.	18
3.9. Natyra dhe biodiversiteti	18
3.10. Bimësia dhe Vegjetacioni	19
3.11. Bota shtazore – Fauna	19
3.12. Peizazhi.....	19
3.13. Ajri	20
3.14. Uji	20
3.16. Zhurma.....	20
4.1. Objektet dhe pajisjet prodhuese	20
4.2. Koncepti prodhues i bazës së betonit	22
4.3. Prodhimet e betonit	22
4.4. Komponentët në procesin e prodhimit të betonit	22
4.5. Përshkrimi i procesit teknologjik.....	25
5.0. IDENTIFIKIMI DHE PËRSHKRIMI I NDIKIMEVE NË MJEDIS.....	28
5.1 Ndikimet e mundshme në shëndetin e njerezve.....	28
5.2 Ndikimet në ajër	29
5.3 Ndikimet në ujë	29
5.4. Ndikimet në tokë.....	30
5.5 Ndikimet në klimë	31

5.6 Nivelet dhe ndikimet e zhurmave.....	31
5.7. Ndikimi në Peisazh	31
5.8. Ndikimi në florë dhe faunë	31
5.9. Ndikimet në vendbanime dhe popullatë.....	32
5.10 Ndikimet ne ekonomi.....	32
5.11. Ndikimet në raste të aksidenteve mjedisore	32
6.0. MARRJA E MASAVE PËR PARANDALIMIN DHE ZVOGËLIMIN E NDIKIMEVE	33
6.1 Masat për emetimet ne ajër	33
6.2 Masat për shkarkimet në ujë	33
6.3 Masat për mbrojtjen e tokës.....	35
6.4. Masat për mbrojtjen e florës dhe faunës.....	37
6.5. Masat e marura për mbrojtjen nga zhurma	37
6.6 Masat e marura për mbrojtjen nga rreziqet aksidenciale	37
7.0 PLANI I MENAXHIMIT DHE MONITORIMIT TE MJEDISIT.....	38
7. Monitorimi	40
9.0 MARJA E MASAVE REHABILITUESE PAS PËRFUNDIMIT TË PROJEKTIT	40
11.0 KONKLUSIONE DHE REKOMANDIME	42
LITERATURA.....	44

1. HYRJE

Në kuadër të plotësimit të dokumentacionit të nevojshëm për lejimin e ndërtimit dhe funksionalizimit të bazës për prodhimin e betonit, kompania/investitori “Doni-Beton” Shpk ka paraparë edhe përpilimin e raportit mbi vlerësimin e ndikimit në mjedis për tu pajisur me Pëlqim Mjedisor nga MMPHI. Raporti i VNM-së do të përfshijë në vete analizat e realizuara të ndikimeve të mundshme në mjedisin rrethues, duke përfshirë edhe botën e gjallë për lokacionin ku planifikohet të bëhet ndërtimi dhe zhvillimi i aktivitetit të prodhimit të betonit në vendin e quajtur QEREMIDE-QEREMIDE, në parcelën me nr. P-71813064-01223-2, në zonën kadastrale Piranë, komuna Prizren.

Raporti i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis paraqet një dokument të nevojshëm dhe të domosdoshëm për paisjen e kompanisë me pëlqim mjedisor nga ana e Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, i cili po ashtu është i nevojshëm për marrjen e lejës ujore, mjedisore dhe licencave tjera përkatëse sipas legjislacionit në fuqi.

Qëllimi i hartimit të raportit është evidentimi i të gjitha kushteve përreth në lokacionin ku bëhet planifikimi për investime dhe realizime të aktiviteve përkatëse, bazuar në faktin se në kohën moderne po bëhen intervenime të vazhdueshme në mjedisin natyror, duke ndikuar kështu në humbjen e balancës ekologjike natyrore. Bazuar në qëllimin paraprak dhe në metodologjinë e hartimit të vlerësimit të ndikimit në mjedis, ky raport bëhet me qëllim të përkufizimit të ndikimeve potenciale dhe caktimin e masave të cilat do të jenë të nevojshme për t’u marrë për mbrojtjen e mjedisit nga ndikimet eventuale negative të këtij aktiviteti. Ndaj është e nevojshme që shoqëria të ndërgjegjësohet për t’a mbajtur sa më pastër mjedisin ku jetojmë duke marrë masat e duhura për trajtimin e mbetjeve, zhurmës dhe emetimit të pluhurit të dëmshëm në atmosferë që gjenerohen nga zhvillimi i aktiviteteve minerare.

Raporti paraqet në mënyrë transparente ndikimin në mjedis gjatë aktivitetit të prodhimit të betonit, në mënyrë që të mundësohet ruajtja e mjedisit.

Ky vlerësim i ndikimit në mjedis për kompaninë „Doni-Beton” Sh.p.k, me seli në Piranë, komuna e Prizrenit, me pronar z. Naser Elshani është hartuar, duke u bazuar në projektin e ndërtimit dhe kapacitetin e prodhimit, karakteristikat e lokacionit, gjendjen ekzistuese të mjedisit rreth lokacionit ku është planifikuar të bëhet ndërtimi i bazës për prodhimin e betonit si dhe dokumenteve tjera ekzistuese.

Detyra e përgatitjes së këtij raporti të VNM-së për bazën e betonit të kompanisë “Doni-Beton” Sh.p.k. ka për qëllim identifikimin e burimeve të ndotjes, vlerësimin e ndikimit të tyre në mjedis si dhe propozimin e veprimeve për parandalimin apo së paku zvogëlimin e ndikimeve negative në mjedis gjerë në kufijtë e lejuar.

Të gjitha konstatimet dhe rekomandimet për mbrojtjen e mjedisit që dalin nga ky raport, duhet të merren për bazë, gjatë fazës së funksionimit të bazës së betonit dhe pas përfundimit të aktivitetit të punës së tij.

2. BAZA LIGJORE E PËRPILIMIT TË RAPORTIT TË VNM-së

Në lidhje me vlerësimin e ndikimit në mjedis (VNM-së) është aprovuar dhe funksionon Ligji për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis Ligji Nr. 08/L-181, i cili përcakton të gjitha procedurat për përgatitjen dhe paraqitjen për miratim të VNM -së.

Ligji për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis Ligji Nr. 08/L-181, ka për qëllim për të siguruar mundësimin e një vlerësimi të përgjithshëm me ndërthurje të ndikimeve mjedisore të projekteve apo veprimtarive që do të realizohen me qëllim që të parandalojnë dhe të zvogëlojnë apo mënjanojnë efektet negative në mjedis në kohën e duhur.

Analiza përfshin identifikimin e masave mbrojtëse për mjedisin me rastin e ndonjë aksidenti në mjedis gjatë funksionimit kontinuel të aktivitetit të bazës për prodhimin e betonit:

- Identifikimin e burimit që rrezikon mjedisin
- Vlerësimin e ndikimit në mjedis
- Propozimin e masave themelore për minimizimin apo zvogëlimin e ndikimeve negative gjerë në kufijtë e lejuar.

2.1. Rregullativa Ligjore

a) Dokumentacioni normativ

Me rastin e hartimit të raportit të VNM-së për kompaninë “Doni-Beton” shpk e cila planifikon të bëjë ndërtimin e bazës për prodhimin e betonit janë marrë për bazë ligjet më të rëndësishme të aplikuara të cilat janë paraqitur si në vijim:

- Ligji për VNM Nr. 08/L-181
- Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit Nr. 03/L-025
- Ligji për planifikim hapësinor Nr. 04/L-174
- Ligji për mbrojtjen e natyrës Nr. 03/L-233
- Ligji për ndërtim Nr. 04/L-110
- Ligji për minierat dhe mineralet Nr. 03/L-163
- Ligji Nr. 04/L-158 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 03/L-163 për minierat dhe mineralet
- Ligji për ujërat e Kosovës Nr. 04/L-147
- Ligji Nr. 08/L-116 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-197 për Kimikate

- Ligji për mbrojtjen e Ajrit nga ndotja nr. 08/L-025
- Ligji Nr. 08/L-071 për ndryshimin e Ligjit Nr. 04/L-060 për Mbeturinat
- Ligji për mbrojtjen nga Zhurma Nr. 02/L-102
- Ligji për mbrojtjen nga zjarri Nr. 04/L-012

Udhëzimit Administrative:

- Udhëzimi Administrativ Nr. 30/2014 për kushtet, mënyrat, parametrat dhe vlerat kufizuese të shkarkimit të ujërave të ndotura në rrjetin e kanalizimit publik dhe në trupin ujor.
- Udhëzimi Administrativ (qrk) Nr.07/2021 për rregullat dhe normat e shkarkimeve në ajer nga burimet e palevizshme të ndotjes.
- Udhëzim administrative MMPH Nr. 04 /2018 për pengimin e aksidenteve të mëdha ku përfshihen substancat e rrezikshme.
- Udhëzim administrative Nr.05/2011 për metodologjinë e vlerësimit të rrezikut nga aksidentet kimike si dhe masat për eliminimin e pasojave.
- Udhëzim administrativ (mmpH) nr.16/2015 për informim, pjesëmarrje të publikut dhe palëve të interesuara në procedurat e vlerësimit të ndikimit në mjedis

b) Dokumentacioni teknik

- Projekti i ndërtimit
- Çertifikata e regjistrimit të biznesit
- Çertifikatat mbi të drejtat e pronës
- Kopja e planit të ngastrës
- Plani i situacionit
- Pelqimin/njoftimi komunal për lejimin e aktivitetit

Duke marrë parasysh faktin se një pjesë e madhe e specifikave mjedisore nuk janë përfshirë në kuadër të rregullativës së sipërshtënëuar për nevojat e hartimit të këtij raporti është shfrytëzuar dhe rregullativa relevante ndërkombëtare si dhe direktivat përkatëse siç është direktiva e VNM-së.

2.2. Metodologjia e Punës

Metodologjia e punës me të cilat bëhet vlerësimi i ndikimit në mjedis për projektin e bazës për prodhimin e betonit, bëhet në disa faza.

a) Informatat themelore, që nënkupton identifikimet siç janë:

- Burimet themelore të ndikimeve në mjedis,
- Popullata ekzistuese me karakteristikat demografike,

- Karakteristikat e dheut, topografia dhe peizazhi në lokacion,
- Klima e lokacionit me të dhënat meteorologjike,
- Kualiteti i ajrit dhe ujit në lokacionin më të gjerë,
- Bota bimore dhe shtazore në terrenin e analizuar,

b) Vlerësimi i ndikimeve sipas këtyre kualifikimeve:

- Madhësia dhe lloji i ndotjës
- Karakteristikat dhe dominimi i materialit ndotës
- Gjendja e mjedisit në terrenin e analizuar
- Vlerësimi i shpërndarjes në hapësirë i materies ndotëse

c) Analiza e rrezikimit të

- Njeriut
- Vlerave materiale
- Vlerave natyrore

d) Përcaktimi i masave mbrojtëse sipas rezultateve të arritura mbi vlerësimin e ndikimit në mjedis në lokacionin ku planifikon të realizohet projekti i ndërtimit të bazës për prodhimin e betonit.

Pjesa më e rëndësishme e analizës së këtij raporti i kushtohet kuantifikimit dhe vlerësimit të gjendjes ekzistuese. Hulumtimi karakterizohet me faktin se kemi të bëjmë me vendin që nuk ka të bëjë me ndonjë potencial të shprehur ekologjik. Rezultati i këtyre analizave paraqet një dëshmi mbi gjendjen aktuale të mjedisit në këtë lokacion.

3.0. PËRSHKRIMI I LOKACIONIT DHE MJEDISIT

Për hartimin e një raporti të vlerësimit të ndikimit në mjedis bazë kryesore e tij janë karakteristikat themelore të mjedisit në të cilin do të zhvillohet aktiviteti i caktuar. Hulumtimi dhe vlerësimi i gjendjes ekzistuese është bërë duke i shfrytëzuar hulumtimet studimore të bëra në këtë teren.

Për t'u definuar gjendja ekzistuese në mënyrë të kënaqshme dhe për të u krijuar një bazë reale për hulumtim të ndikimeve të mundshme, në kuadër të gjendjes ekzistuese janë prezantuar edhe të dhënat relevante që kanë të bëjnë me të dhënat ekzistuese morfologjike, gjeologjike, hidrologjike, hidrografike dhe meteorologjike.

3.1. Potencialet ekzistuese

Njëri nga elementet kyçe të hulumtimi i gjendjes ekzistuese të mjedisit është hulumtimi i potencialit ekzistues, e që konsiston në analizën e mirëfilltë të tërësisë hapësinore në zonën më

të gjerë të projektit për ndërtimin e bazës për prodhimin e betonit me qëllim që në bazë të pasojave të njohura të vlerësohen mundësitë e rrezikut ekologjik dhe në bazë të tyre të rekomandohen masat për zvogëlimin ose edhe eliminimin e tyre. Karakteristikat e potencialit ekologjik përbëhen nga kombinimi i ndikimeve të ndërsjella të faktorëve natyror siç janë toka, uji, ajri, reliefi, flora dhe fauna. Çdonjëri nga potencialet ekologjike në këtë mënyrë posedon funksione të caktuara, që në esencë kanë rëndësi të dorës së parë analizën e problematikës së tërësishme të mbrojtjes së mjedisit. Ndikimi i ndërsjellë i faktorëve të veçantë si dhe ndikimi i tyre në formimin e potencialit ekologjik dhe i funksioneve të tyre themelore me interes për analizën në fjalë, së bashku me kompleksin e marrëdhënieve të mundshme është paraqitur në figurën nr.1.




Fig. 1. Raportet themelore ndërmjet faktorëve natyrorë dhe potencialeve ekologjike.

Në bazë të raporteve të paraqitura në figurën 1 është e qartë që faktorët natyror formojnë disa potenciale natyrore karakteristika funksionale të cilave duhen marrë parasysh gjatë valorizimit të projektit të bazës për prodhimin e betonit në zonën kadastrale Piranë komuna e Prizrenit.

3.2. Të dhëna teknike të aktivitetit

Investitori për realizimin e këtij projekti do të pajiset me të gjitha miratimet përkatëse të lejeve të nevojshme për lejimin e projektit të bazës për prodhimin e betonit. Pronësia e truallit për realizimin e këtij projekti është pronë private e Naser Elshanit nga Piranë e Prizrenit njëhërit edhe pronar i kompanisë “Doni-Beton” shpk.

3.3. Pozita gjeografike e lokacionit

Lokacioni i planifikuar për ndërtimin e bazës për prodhimin e betonit ndodhet në vendin e quajtur Qeremide-Qeremide, në parcelën me numër P-71813064-01223-2, me sipërfaqe prej 7280 m², sipas koordinatave të paraqitura në situacionin e terrenit, në zonën kadastrale Piranë, Komuna e Prizrenit.

Toka ku parashihet ndërtimi ka destinim si tokë bujqësore, ara të klasës IV, dhe është në pronësi të z. Rexhep (Mamut) Elshani, bazuar në fletën poseduese me numër të lëndës 07-029-4866-25-Ç, të datës 10.06.2025.

Në bazë të analizave të kryera, është bërë një vlerësim i përgjithshëm i gjendjes ekzistuese të mjedisit jetësor si dhe i ndikimeve të mundshme negative që mund të paraqiten gjatë zhvillimit të aktivitetit ndërtimor dhe operativ të bazës së betonit. Këto vlerësime shërbejnë si bazë për kuantifikimin e ndikimeve të mundshme dhe për përcaktimin e masave të nevojshme mbrojtëse, duke pasur parasysh natyrën industriale të këtij projekti.

Lokacioni i planifikuar ndodhet pranë magjistrales Prizren–Gjakovë, dhe afër tij kalon linja hekurudhore që lidh rajonin e Prizrenit me Fushë Kosovën dhe Prishtinën. Në jugperëndim të parcelës gjendet fshati Krajë, i cili kufizohet me fabrikën e bllokave, ndërsa në pjesën veriore ndodhen fshatrat Sërbica e Poshtme, dhe në juglindje fshati Landovicë.

Lokacioni karakterizohet nga një terren i rrafshët, i përshtatshëm për ndërtimin e një baze industriale për prodhimin e betonit dhe aktivitete të tjera minerare. Në një distancë rreth 1300 metra kalon lumi Drini i Bardhë.

Komuna e Prizrenit, me një sipërfaqe prej 640 km² (5.94% e territorit të Kosovës), ndodhet në jugperëndim të vendit. Kufizohet me komunat Gjakovë, Rahovec, Suharekë, Shtërpçë dhe Dragash, si dhe me shtetet e Shqipërisë dhe Maqedonisë së Veriut. Rrafshi i Prizrenit ndodhet në një lartësi mesatare prej 300 m mbi nivelin e detit, ndërsa disa nga majat e maleve të Sharrit tejkalojnë 2000 m mbi nivelin e detit.

Në afërsi të lokacionit për ndërtimin e bazës së betonit ekzistojnë objekte dhe aktivitete të tjera industriale, si: Fabrika për prodhimin e bllokave "IMN Tulltorja" Sh.p.k, e cila gjendet në anën tjetër të rrugës. Baza ekzistuese e betonit në pronësi të kompanisë "Doni-Beton". Autoservise, pompa të benzinës, depo të materialeve ndërtimore, markete, etj. Në një distancë rreth 200 metra fillojnë të paraqiten edhe disa shtëpi të banimit.

Këto objekte dhe aktivitete të tyre mund të shihen në pamjet satelitore të bashkëngjitura më poshtë.



Foto 1. Pamje satelitore e lokacionit ku planifikohet të bëhet ndërtimi i bazës për prodhimin e betonit


Në kohën kur është hartuar Raporti për vlerësimin e Ndikimit në mjedis, për t'u pajisur me Pëlqim Mjedisor nga ana e MMPHI kompania ka bërë vëndosjen e bazës për prodhimin e betonit, por ende nuk e ka lëshur në funksion. Më poshtë janë të bashkangjitura fotografi nga tereni dhe parcela se ku është bërë planifikimi i realizimit të këtij projekti.


LEND: SITUACIONI I TERRENIT PER BAZEN E BETONIT

KOORDINATAT E PARCELES 1223-2		
Nr.	Y(m)	X(m)
1	7473585.750	4682356.004
2	7473582.435	4682460.482
3	7473587.282	4682463.253
4	7473616.016	4682479.603
5	7473630.462	4682488.572
6	7473649.670	4682469.046
7	7473676.180	4682420.550
8	7473623.395	4682383.325
KOORDINATAT E PUNJ		
Nr	Y(m)	X(m)
100	7473646.562	4682471.080

LEGIENDA:

	Kufiri Kadostrat
	Baza e Betonit
	Muri
	Objekti ndimes
	Pusi
	Puzer Kamali
	Trafa
	Dezator
	Bazeni për Trajtim të Ujrave
	Bazeni i Ujit





3.2. Popullata dhe Vendbanimet

Njërën nga veçoritë qenësore të hapësirës së analizuar, në kuptim të përcaktimit të ndikimeve të mundshme në mjedis, paraqet popullata dhe demografia e saj. Këto fakte kuptimin e plotë të tyre e kanë në hulumtimin e hollësishëm të ndikimeve të mundshme negative në banorë që jetojnë në hapësirën e analizuar.

Komuna e Prizrenit përfshin një sipërfaqe prej 640 km² (5.94 % të territorit të Kosovës) posedon 76 vendbanime me 220.776 banorë nga të cilët në Prizren jetojnë rreth 110.000 banorë. Komuna e Prizrenit, në bazë të sasisë së ujit është një ndër vendet më të pasura. Kjo pozitë krijon të gjitha parakushtet për zhvillimin e kulturave bujqësore, blegtorisë, industrisë ushqimore dhe të turizmit në bazë të modelit të Austrisë, Sllovenisë, Zvicrës.

Përmes anës së Prizrenit kalon rruga më e shkurtër që bashkon pjesën qendrore të gadishullit Ballkanik me detin Adriatik.

Kjo rrugë, për arsye politike nga e kaluara sot nuk ka rëndësi aq të madhe, është një rast i mirë që me valorizimin e saj të shfrytëzohen të gjitha përparsit e saj, duke marrë parasysh që në të kaluarën ka pas ndikim primar në zhvillimin e Prizrenit. Kushtet hidrologjike dhe kushtet natyrore të komunës së Prizrenit ndikojnë në zhvillimin e bujqësisë dhe për zhvillimin e aktiviteteve turistike dhe rekreative. E gjithë kjo ka ndikim në strukturën ekonomike të Prizrenit.

Prandaj bujqësia dhe turizmi merret si pjesë madhore e aktiviteteve ekonomike në komunën e Prizrenit. Në afërsi të drejtpërdrejt të lokacionit të planifikuar për vendosjen e bazës së betonit nuk ka objekte banimi, objektet banimit gjenden në largësi rreth 300 m, prandaj edhe nuk do të ketë ndonjë ndikim relevant në popullatë, përpos që do të kenë vetëm dobi sepse disa prej këtij komunitetit do të punësohen në këtë kompani. Ndërsa popullata e këtij rajoni merret kryesisht me bujqësi dhe blegtori.

3.3. Infrastruktura ekzistuese

Lokacioni i planifikuar për vendosjen e bazës për prodhimin e betonit gjendet pranë magjistrales Prizren–Gjakovë, dhe afër tij kalon linja hekurudhore që lidh rajonin e Prizrenit me Fushë Kosovën dhe Prishtinën. Në jugperëndim të parcelës gjendet fshati Krajkë, i cili kufizohet me fabrikën e bllokave, ndërsa në pjesën veriore ndodhen fshatrat Sërbica e Poshtme, dhe në juglindje fshati Landovicë.

Lokacioni karakterizohet nga një terren i rrafshët, i përshtatshëm për ndërtimin e një baze industriale për prodhimin e betonit dhe aktivitete të tjera minerare. Në një distancë rreth 1300 metra kalon lumi Drini i Bardhë.

Baza e betonit ka dalje në rrugën dytësore që lidhë fshatin Serbicë e Poshtme me rrugën regjionale Prizren- Gjakovë, e që pastaj kjo rrugë të lidhë me autostraden “Ibrahim Rugova”, autostradë e cila të lidhë më Shqipërinë me pjesën Verilindore të Kosovës me Maqedonin e Veriut dhe në Pjesën Jugore me Shqipërinë. Pra, këto rrugë lidhin shumë mirë lokacionin e bazës së betonit me të gjithë rrjetin rrugor të Kosovës.

3.4. Kushtet klimatike

Klima e kësaj treve sipas pozitës së saj gjeografike, lartësisë mbi detare dhe sipas hulumtimeve meteorologjike siç janë: reshjet dhe temperaturat mesatare mujore dhe vjetore, është klimë kontinentale. Në viset e ulta për shkak të ndikimit të klimës mesdhetare dhe verave shumë të

nxehta të korrurat janë ndër të parat në Evropën juglindore prandaj ekzistojnë përparësitë e pakrahasueshme për kulturat bujqësore: Hardhia e rrushit, pemët dhe perimet. Në viset malore, dominon klima e alpeve, për ç'arsye deri në qershor nëpër gropa mbeten sasi të bores me ç'rast në mes të verës mund të zbardhohen majet e maleve

Sa i përket reshjeve dhe temperaturave, Pranvera dhe Vjeshta karakterizohen përafërsisht me klimë të njëjtë. Të reshurat janë të formës riguese ose me karakter lokal. Temperatura mesatare sillet prej 11,5°C gjer në 12,5°C e si mesatare e këtyre merret temperatura prej 12,0°C. Temperaturat më të larta janë në muajin qershor 35,6°C, ndërsa në korrik 32,4°C dhe në gusht 31,1°C. Temperaturat më të ulta janë në muajin dhjetor, janar dhe shkurt. Temperaturat maksimale mesatare vjetore janë 22,5°C, ndërsa temperaturat mesatare minimale sillen prej -0,5°C. Regjimi i reshjeve në komunën e Prizrenit ka karakterin e klimës aride. Shuma e përgjithshme e reshjeve sillet nga 670 mm deri në 820 mm. Vlera mesatare vjetore e lagështirës relative është 66.8%. Muaji më i thatë është gushti 66.2%, kurse më me lagështi janë nëntori dhe dhjetori 84.2 %.

3.5. Erërat

Në lokacionin ku është planifikuar të vendoset baza për prodhimin e betonit, për shkak të konfiguracionit e posaçërisht pozitës gjeografike më së shumti janë të përfaqësuara erërat veriore. Me intensitet më të madhe të shpejtësisë paraqiten erërat veriore, veri perëndimore si dhe erërat perëndimore, kurse ato jugore janë me intensitet më të vogël. Në komunën e Prizrenit erërat më të shpeshta janë ato veriore me 225‰ dhe më të rrallat janë ato jug – perëndimore me 226‰, kurse shpejtësia mesatare më e madhe e erës është 3.2 m/sek.

3.6. Relievi

Rajoni i gjerë ku planifikohet të zhvillohet aktiviteti i prodhimit të betonit dhe kryerja e aktiviteteve tjera minerare në Zk. Piranë karakterizohet me një relief mesatar kodrinor – malorë. Relievi me lartësin, pjerrtësinë, formën dhe konfiguracionin ndikon në ndërtimin e elementeve klimatik, në shfaqjen e rrjetit ujor dhe të bimësisë. Lokacioni shtrihet në terrenin kodrinor me lartësi mesatare mbidetare prej 330-620 metra. Këtu mbizotërojnë sendimentet e reja me toka argjilore të formuara nga mbetjet liqenore me konglomerat, sendimentet argjilore, humusi dhe ndërfaqe të rërës dhe zhavorrit etj.

3.7. Hidrogeologjia

Në aspektin hidrologjik ujërat sipërfaqësorë të komunës së Prizrenit karakterizohen me ujëra të bollshme sipërfaqësore të cilat drenohen në lumin Drini i Bardhë. Nëpër komunën e Prizrenit

kalon lumi më i madh në Kosovë, Drini i Bardhë. Ky përshkon pjesën perëndimore të Kosovës, respektivisht Rrafshin e Dukagjinit për 122 km në drejtimin veri-jug, buron nga një gurrë në Bjeshkën e Rusolisë, sipër fshatit Katundi i Ri në vendin e ashtuquajtur Radavc (afër qytezës së Burimit), thellësitë e ujërave nëntokësore në këtë lokalitet nuk janë studiuar. Ujërat e lumit të Drinit të Bardhë nevojiten për ujitjen e tokave që shtrihen afër shtratit të tij.

Veçoritë hidrogeologjike të lokacionit ku planifikohet të vendoset Baza për prodhimin e betonit janë të thjeshta, ndërsa burime natyrore të ujit nuk ekzistojnë, përveç ujërat sipërfaqësore të cilat krijohen gjatë të reshurave atmosferike të cilat drenohen në kanalet natyrore (prockat) dhe pastaj drenohen në lumin e Topllues e pastaj derdhen në Drinin e Bardhë i cili ekziston në distancë mbi 1300 metra, ndërsa lumi topllua gjendet në distancë 1500 metra nga sipërfaqja ku planifikohet të vendoset Baza për prodhimin e betonit.

3.8. Ndërtimi gjeologjik i vendburimit (Përfshirë një hartë gjeologjike të rajonit)

Ndërtimi gjeologjik i territorit të gjerë në këtë lokalitet është i ndërtuar nga gëlqeror të shtresëzuar të kretës së sipërme, depozitimeve të pliocenit, të cilat i përmbajnë argjilat zjarrduruese si dhe depozitimeve aluviale. Më larg nga këto depozitim të përmendura më lartë, të cilat përbëjnë, pjesën kryesore të ndërtimit gjeologjik, për rreth lokacionit paraqiten formacionet e serpentinitit dhe diabazë - strallore. Këto formacione vetëm i përmendem mirëpo nuk janë aq shumë të rëndësishëm për këtë lokalitet ku do të bëhet vendosja e bazës së betonit.

3.8.1 Kreta e Sipërme (K2.2)

Në territorin e lokacionit, kreteta e sipërme përfaqëson sedimentet bazë. Janë të zbuluara në pjesën perëndimore të Zymit, me një sipërfaqe prej afro 16 km². Ato janë gëlqeror mjaft të shtresëzuar me ngjyrë të përhimët, e cila seri ka ulje të terrenit në drejtim kah veriu. Këndi i rënies së këtyre sedimenteve është 170/25. Në pjesën jugore këto sedimente janë të mbuluara me depozitimet të pliocenit në formë të korridorit të cilët i ndajnë gëlqeroret e zymit nga gëlqeroret e Rahovecit në jug, këto depozitime mbulesore janë aluvionet rëra, zhavorri dhe lym.

Në shtresat e gëlqerorëve është zbuluar fauna:

- Radiolites peroni
- Eoradiolites Franolii
- Nerinca forojuliansis
- Nerine m.sp. Verëijk.

3.8.2 Plioceni (Pl 3)

Depozitimet e pliocenit kanë shtrirje mjaft të gjerë në këto hapësira. Në terrenin e kërkuar, sipas pozicionit, paraqesin pjesën veri- perëndimore të depozitimeve të pliocenit, të ultësirës së Prizrenit. Në lindje në drejtim të Reqanit janë gëlqeror të turonianit ndërsa ka Zymi në perëndim takojmë gëlqeror të kretes së sipërme ndërsa në ultësirën e Drinit të Bardhë në drejtim të ardhjes së lumenjve janë të mbuluara me depozitime aluviale.

Sedimentet e pliocenit përfaqësojnë pjesën e butë të terrenit me kuota në afërsi prej 310-350 metra. Kompleksin e këtij ndërtimi sedimentlogjik e përbëjnë kryesisht argjila pluhurore me ngjyrë të verdhë, argjila ranore, rëra e imët e verdhë si dhe argjilore me zhavorrë. Anëtari dominues në këtë sedimente është argjila ranore e cila përmban pjesën dërmuese të këtyre rezervave. Në këto pjesë eksplatimi i argjilës ka filluar qysh para disa viteve e cila është përdorur si lëndë e parë për prodhimin e materialit ndërtimor gjegjësisht është përdorur për prodhimin e tullave të plota dhe bllokave për ndërtimtari. Rërat kokërr të mëdha dhe zhavorr i paraqitet në masë më të vogël dhe atë si ndërftje të këtyre masave ranore në argjila si: rërë argjilore është e shpeshtë në shtresat e argjilës e cila seri është e volitshme dhe paraqet një seri litologjike mjaft të favorshme për prodhimin e materialit ndërtimor por vetëm me një përqindje të caktuar të përzier me argjila.

Fauna është vërtetuar në shtresat ne rëra dhe në argjila ranore e cila ceket më poshtë:

- Dreissenisa sp.
- Viviparus (Viviparus) metohiensis Pavl.
- Lithoglyphus fuscus Ziegel.
- Dreissenisa mynsteri Brus.
- Viviparus (V) conica Pavl.

Në bazë të këtyre fosileve të prezantuara më lartë është vërtetuar edhe kati Leventian gjegjësisht i takojnë pliocenit të sipërm. Karakteri i këtyre fosileve si dhe shtresëzimi i qymyreve në pjesë të veçanta të kësaj serie tregojnë në sedimentimin e regjimit liqenor të ujërave mesatarisht të ëmbla.

3.8.3 Kuaternari (Q)

Në depozitimet kuaternare takojmë aluvinet përgjatë Drinit të Bardhë dhe degëzimit të tij me lumeje Topllua dhe përroska tjera. Këto depozitime janë kryesisht zallishtore, rëra dhe suargjila. Është me rëndësi të përmendet që pjesët zallishtore të cilat paraqiten në këto depozitime janë mjaft të imëta dhe nuk kalojnë madhësinë më shumë se 60 mm.

Trashëësia e aluviale sillet rreth 4 - 6 metra, formimi i tyre vjen nga shkatërrimi i gëlqeroreve, strallore dhe diabazeve. Kanë paraqitje të rrallë edhe kokrrizat e serpentiniteve dhe rreshpeve dobët të kristalizuar.

Zalli dhe rëra nga Drini i bardhë është shfrytëzuar në ndërtimtari për beton, për savatim dhe për prodhimin e elementeve nga betoni si kubëza etj. Për nga përmbajtja petrografike dhe analizave fiziko-mekanike të këtij materiali tregohen që mjaft me sukses mund të përdoret në ndërtimtari dhe për ndërtim të rrugëve.

3.8.4 Harta Gjeologjike e Rajonit për Kompaninë Doni-Beton sh.p.k.



Përbërja masive Gjeologjike: Rëra, Argjilë me rërë, Argjila & zhavorre.

Mosha: Pliocen, (Pl_{2,3}), nënkati: Piacenzian (3.600 M/vite), dhe Zanclean (5.332 M/vite).

 Rëra, Argjilë me rërë, Argjila & zhavorre,  Aluvione,  Proluvion

3.9. Natyra dhe biodiversiteti

Në bazë të të dhënave zyrtare të Institutit për mbrojtjen e Natyrës, nuk ekzistojnë të dhëna se kjo hapësirë është ndonjë hapësirë e mbrojtur me ligj, në drejtim të biodiversitetit dhe natyrës në përgjithësi, por as që është potencial të futet zonë në mbrojtje.

3.10. Bimësia dhe Vegjetacioni

Problematika e gjendjes ekzistuese të llojeve bimore nuk është studiuar në masë të mjaftueshme për të sjell përfundime meritore. Në bazë të shqyrtimeve vizuale në lokacionin ku do të vendoset baza për prodhimin e betonit kemi hasur në bimësi që karakterizohet kryesisht nga bimët e ulta barishtore, manaferra, shkurre, si kaçuba të qarrit, bungut, akacia etj. Këto bimë u përshtaten kushteve të jetës së tyre në argjila, në këtë hapësirë gjenden edhe kaça, murrizi, mana, manaferra, etj. Pjesa e ngastrës në fjalë posaçërisht është e zhveshur diku diku e mbuluar me drunj të ultë në formë të kaçubave, pjesa e ngastrës ku do të vendoset baza e betonit, nuk përmbajnë vlera ekonomike në kuptimin e përdorimit si tokë bujqësore, por me shume mund të shfrytëzohet edhe si zone me vlera kullose.

3.11. Bota shtazore – Fauna

Problematika e gjendjes ekzistuese të llojeve shtazore nuk është studiuar në masë të mjaftueshme për të sjell përfundime meritore në këtë domen.

Bazuar në florën ekzistuese dhe kushtet klimatike të rajonit të Prizrenit, e duke marrë për bazë edhe të dhënat nga vendasit, në këtë zonë jetojnë gjitarët, zvarranikët, brejtësit, insektet e ndryshme, lepuri i egër, dhelpra, ujku, derri i egër, iriqi etj. Prej brejtësve jetojnë- mijtë, prej zvarranikëve- gjarpri i zakonshëm, bolla, breshkat e tokës zhapini i gjelbër, insektet krahë fortë, krahë lusporë, mizat etj, ndërsa prej shpezëve janë karakteristike zogjtë, çafkat, bilbilat, thëllënëza e fushës, sorrat, shqiponja, lakuriqi, etj.

3.12. Peizazhi

Karakteristikat e peizazhit të tërësisë së analizuar hapësinore paraqesin njërin nga elementet për të përceptuar marrëdhëniet e tërësishme në relacionin kompleks i aktivitetit të prodhimit të betonit – mjedis. Me këtë rast gjithsesi duhet marrë parasysh se bëhet fjalë për një kategori psikologjike afektive e cila manifestohet përmes veprimit të tërësishëm sinergjik të rrethinës në shikuesin, ku medoemos janë të pranishme implikimet kulturologjike, sociologjike dhe subjektive.

Efektet vizuale (peizazhet) janë kriteriume me rëndësi në ruajtjen e mjedisit dhe nëse nuk zgjidhen drejt konsiderohen si degradim i mjedisit. Andaj pritët nga kompania që të punoj në harmoni me natyrën dhe të mos ndikoj në aspekt negativ në pamjen vizuale të zonës ku bëhen planifikime për vendoset baza për prodhimin e betonit.

3.13. Ajri

Nga vetë konfiguracioni i terenit ku do të bëhet vendosja e bazës së betonit dhe kryerja e aktiviteteve tjera minerare, dhe prezenca e florës, në afërsi gjendet fabrika e materialit ndërtimor IMN Tulltorja shpk, megjithatë mund të konkludojm se pastërtia e ajrit në këtë region është në nivel të lakmueshëm, mirëpo frekvenca e automjeteve në rrugën regjionale Prizren- Gjakovë, ndikojnë në ndotjen eventuale të ajrit, ndotja e pjesërishtme e ajrit vjen edhe nga prodhimi i betonit në këtë lokalitet, poashtu në ndotje mund të ndokoj edhe mekanizmi të cilët përdorën për kryerjen e aktiviteteve bujqësore.

3.14. Uji

Ndotja e ujit shkaktohet nga trafiku i cili zhvillohet në rrugën regjionale Prizren- Gjakovë dhe nga shpërlarja e trasës së rrugës me të reshurat atmosferike. Ndotja e ujit pjesërisht shkaktohet edhe nga lëshimi i ujërave të zeza nga komuniteti të pa trajtuara, pasi që ekzistojnë objekte industriale fabrika e bllokave Tulltorja në këtë lokacion, prandaj pasi nuk ka ndotës potencial të ujërave, mund të konkludojm se pastërtia e ujit në këtë lokacion është në nivel të lakmueshëm.

3.16. Zhurma

Në lokacionin e analizuar/në studim kemi matje të zhurmës, sepse kompanisë “Doni-Beton” shpk, sipas ligjit i kërkohej matjet e nivelit të zhurmës në mënyrë periodike, me qëllim pajisjen me leje mjedisore dhe raportimin për pjesën që aktualisht është duke kryer aktivitetin e prodhimit të betonit. Zhurma që krijohet në lokacionin ku do të vendoset baza për prodhimin e betonit, me infrastrukture përcjellëse, shkaktohet nga transportimi i gurit gëlqeror, mbushja e sillosve me çimento, transportimi i betonit, etj. po ashtu zhurma mund të vijë edhe nga makinat transportuese të fraksioneve të rëres.

Mund të konstatojmë se me respektimin e standarteve dhe normave të lejuara lidhur me aktivitetin minierar, nuk gjeneron ndonjë zhurmë të përhershme që do të ndikonte në psikikën dhe koncentrimin njeriut në punë dhe rrethinë.

4. 0. PROCESI TEKNOLOGJIK I PRODHIMIT TË BETONIT

4.1. Objektet dhe pajisjet prodhuese

Kompania “Doni-Beton” SHPK bazë për prodhimin e llojeve të betoneve në zonën kadastrale në zonën kadastrale Piranë, komuna Prizrenit do të vendos një betoniere dhe pajisjet për prodhimin e betonit, që do të shënohen në vijim.

Baza për prodhimin e betonit përbëhet prej këtyre objekteve dhe pajisjeve:

- Objekti i administratës
- Kabina për komandimin e betonierës
- Tipi i betonierës: Polygonmach
- Viti i prodhimit: 2025
- Vendi i origjinës: Turqi
- Kapaciteti i prodhimit: 100 m³/orë
- Siloset për çimento: 2 copë me kapacitet 100 m³ = 200 m³
 - Siloset për fraksione: pesë silose me kapacitet nga 4 x 30 m³ = 120 m³, 0–4 mm
 - 4–8 mm
 - 8–16 mm
 - 16–22 mm
 - 22–31.5 mm
- Mikserët, kapaciteti: 5 copë 9 m³
- Makinë ngarkuese e rërës: 1 copë
- Kapaciteti i pompës: 100 m³/h
- Autocisternë: s'ka
- Peshore automatike për matjen e agregatit dhe çimentos
- Shirit transportues horizontal mbledhës – dozator
- Rezervuar për aditivë me kapacitet prej 1.000 litrash, me pompë për aditivin
- Rezervuar për ujë, me kapacitet: 20 000 litra
- Rezervuar për derivate të naftës, me kapacitet: 6000 l
- Pompa me sistem për furnizim me ujë, kapaciteti: 250 l/min; 1.5 kë
- Shtyllat dhe platforma ku është vendosur mikseri (përzierësi); 4 m
- Shtyllat dhe platforma ku janë vendosur siloset e çimentos 4 m
- Gjenerator për furnizim me energji elektrike, me kapacitet: 110 kë/h
- Trafo personale, me kapacitet: 160 kë/h
- Kompresor për furnizim me ajër të komprimuar: (V = 500 litra)
- Pus personal: 1 pusë
- Hapësirë për pastrimin e autocisternave; po
- Kabina komanduese e bazës së betonit; po
- Eurofiltra në siloset e çimentos; po
- Trajtimi i ujërave: kompania ende nuk posedon sistem për trajtimin e ujërave

Betoniera është adekuate për prodhimin e betonit dhe i përgjigjet standardeve ISO.

Ne fotot në vijim shihet baza për prodhimin e betonit dhe pajisjet e bazës nga disa pozicione të ndryshme.

4.2. Koncepti prodhues i bazës së betonit

Kompania “Doni-Beton” SHPK në zonën kadastrale Piranë, komuna Prizrenit ka planifikuar ndërtimin e bazës për prodhimin e betonit me teknologji dhe pajime moderne, me të cilat mund të prodhohj të gjitha llojet e betonit të cilësisë së lartë. Materialet e nevojshme për prodhimin e betonit janë: çimentoja, fraksionet e gurit/rërës, uji dhe aditivët.

Fraksionet e gurit/rërës janë: +0-4mm, +4-8mm, +8-16mm, +16-22 mm,dhe +22-31.5 mm, varësisht prej llojit të betonit i cili planifikohet të prodhohet edhe fraksionet kombinohen. Procesi i prodhimit të betonit është proces i mbyllur, i tërë procesi kontrollohet dhe menaxhohet në mënyrë bashkëkohore.

4.3. Prodhimet e betonit

Betoni paraqet konglomerat që përfitohet me përzierjen e çimentos, fraksioneve të rërës/gurit dhe ujit.

Me programin e prodhimit parashihet prodhimi i këtyre llojeve të betoneve:

- Betonet Plastike 0-16 (MB15, MB20, MB25, MB30, MB35, MB40)
- Betonet Plastike 0-31.5 (MB10, MB15, MB20, MB25, MB30, MB35, MB40)
- Beton i Ajruar 0-16 (MB20, MB25, MB30, MB35, MB40)
- Beton i Ajruar 0-31.5 (MB20, MB25, MB30, MB35, MB40)
- Beton i qëndrueshëm ndaj ujit 0-16 (MB20, MB25, MB30, MB35,)
- Beton i qëndrueshëm ndaj ujit 0-31.5 (MB20, MB25, MB30, MB35).

Përpos këtyre llojeve të betoneve mund të prodhohen edhe lloje të veçanta të betoneve: për ndërtim të rrugëve, urave, tunele, për konstruksione nën ujë, etj.

4.4. Komponentët në procesin e prodhimit të betonit

Çimentoja - paraqet komponentin lidhës të betonit. Sipas teknologjisë për prodhimin e betonit në betonier përdorët çimentoja Portland. Në raste të veçanta varësisht prej llojit të prodhimit të betoneve, përdoren çimentot speciale. Cilësia e çimentos përcaktohet në bazë të aftësisë lidhëse

të shprehur nëpërmjet fortësisë. Sasia për prodhimin e betonit, përkatësisht harxhimi specifik i çimentos, është 200-400 kg për 1m³.

Agregati – guri ose rëra - Kompania “Doni-Beton” SHPK, këtë material (fraksionet e gurit gëlqeror/ose rërën) për arsye të cilësisë së lart të dëshmuar furnizohet nga gurthyesi dhe seperacioni që aty gjitur, e cila njëherit është pronë e të njëjtës kompani.

Agregati duhet të përmbush kushtet e parapara në pikëpamje të cilësisë dhe granulimit. Rëra cilësore duhet të jetë e pastër dhe me përbërje të lartë të kuarcit. Agregati duhet të jetë pa asnjë shtesë të cilat reagojnë me ujin dhe shkaktojnë shkapërderdhje, kloridet, sulfatet dhe komponimet tjera kimike që dëmtojnë vetit fizike dhe mekanike të betonit nuk gëzojnë të jenë të pranishme.

Materiet organike dhe humusi pengojnë ngurtësimin e çimentos në beton. Preferohet që raporti i agregatit në beton të jetë 1:2-1:7, varësisht prej llojit të betonit që kërkohet të prodhohet.

Uji- është komponent i rëndësishëm për lidhje gjatë prodhimit të betonit. Çështjen e ujit pronari e ka zgjidhur më anë të pusit, të cilin e ka shpuar nën tokë dhe me anë të pompave e mbushë rezervuarin me kapacitet 250000 litra i cili nevojitet për mbajtjen e ujit rezervë për nevoja të betonierës, pusi dhe rezervuari gjinden në afërsi të betonierës.

Në procesin e prodhimit të betonit duhet të përdoret vetëm uji i pastër, ujë që nuk përmban materie organike që formohen nga bimët e kalbura.

Harxhimi specifik i ujit në procesin teknologjik për prodhimin e betonit varet nga lloji i betonit që dëshirojmë të prodhojmë. Në vijim do të jepet përqindja e ujit në beton në varësi nga lloji i betonit:

- për beton të lëngshëm 6- 8%
- për beton plastik 7- 9%
- për beton të fortë plastik 8-10%

Siç e kemi cekur në pasuset e më sipërme në këtë betoniere mund të prodhojmë beton të kualiteteve të ndryshme duke u bazuar në destinimin e tij dhe atë sipas nevojës dhe kërkesave të hargjuesve të betonit.

Në tabelën e më poshtme po e japim një shembull që paraqet sasinë e agregatit sipas fraksioneve dhe atë pa fraksionin +16-31.5 mm, sasinë e çimentos dhe sasinë e ujit që nevojitet për prodhimin e 1m³ beton llojit MB-30, sipas recepturës së caktuar:

Agregati

fraksionet +0-4mm +4-8mm +8-16mm

përqindja 45% 20% 35%

sasia 824 kg 366 kg 642 kg = 1832 kg

Çimentoja 350 kg

Uji 238kg

Nga kjo recepturë e lartshënuar mund të caktohet edhe bilanci material për prodhimin e 1m³ beton që shihet në tabelën e më poshtme:

Hyrja		Dalja	
Agregati	1832 kg	1m ³ beton	2420 kg
Çimentoja	350 kg		
Uji	238 kg		
Bilanci i përgjithshëm	2420 kg		2420 kg

Në tabelën në vijim po e japim një shembull për sasinë e agregatit sipas fraksioneve dhe atë me katër fraksione, sasinë e çimentos dhe sasinë e ujit që nevojitet për prodhimin e 1m³ beton llojit MB-30, sipas recepturës së caktuar:

Agregati

fraksionet +0-4mm +4-8mm +8-16mm +16-31,5 mm

përqindja 40% 15% 35% 25%

sasia 756 kg 283 kg 378 kg 473 kg = 1890 kg

Çimentoja 320 kg

Uji 220 kg

Nga kjo recepturë e lartshënuar mund të caktohet edhe bilanci materialit për prodhimin e 1m³ beton që shihet në tabelën e më poshtme:

Hyrja		Dalja	
Agregati	1890kg	1m ³ beton	2430kg
Çimentoja	320kg		
Uji	220kg		
Bilanci i përgjithshëm	2430kg		2430kg

4.5. Përshkrimi i procesit teknologjik

Prodhimi i betonit në betonier fillon me përgatitjen e lëndëve të para: agregatit (fraksioneve të gurit apo fraksioneve të rrërs), çimentos dhe ujit.

Procesi teknologjik për prodhimin e betonit, fillon me mbushjen e siloseve me guri gëlqeror me granulacione të ndryshme në varësi të markës së betonit që dëshirohet të prodhohet, siloset mbushen me anë të lopatës ngarkuese me fraksione të gurit ose rrërs nga depoja e fraksioneve të agregatit, siloset janë të ndara njëra prej tjetrës me mure të pllakave të qelikut.

Proces tjetër paraqitet mbushja e siloseve me çimento të tipit të caktuar, mbushja bëhet me anë të auto-cisternave me proces pneumatik.

Në procesin teknologjik bëjnë pjesë tërë sistemi i pajimeve të furnizimit me ujë, pompave hidraulike, pneumatikës, pajimeve elektrike dhe automatike në veçanti.

a. Agregati nga të katër siloset ku në dalje të cilëve ndodhën dozuesit elektro- pneumatik të cilët me dhënien e komandës nga tabela komanduese hapen dhe mbyllen në mënyrë automatike pasi ta lëshojnë sasinë e caktuar të agregatit në shiritin transportues horizontal që ndodhet nën siloset e agregatit i cili i transporton granulacionet (fraksionet) e agregatit gjerë në shiritin transportues të pjerrtë i cili nevojitet për bartjen e fraksioneve të agregatit gjerë në mikser (përzierës) për prodhimin e betonit. Në dozuesit e fraksioneve më të imta janë të vendosur vibruesit me qëllim të rrjedhjes së fraksioneve sa më lehtë në shiritin transportues horizontal, kur të dozohet sasia e dëshiruar e agregatit, në transportier e pastaj nga transportieri shiritor në shiritin transportues të pjerrtë i cili nevojitet për bartjen e fraksioneve të agregatit gjerë në mikser (përzierëse).

b. Dozimi i çimentos në përzierës bëhet nëpërmes transportuesit kërmillor nga siloset. Çimentoja me ramje të lirë bien në transportuesin të vendosur nën silos, pasandaj nëpërmjet transportuesit kërmillor dozohet në enën e peshojës për çimento. Zbrazja e enës së peshorës kryhet në mënyrë të programuar dhe atë në kohën e dozimit të agregatit në mikser (përzierëse). Ashtu që zbrazja e pajisjes për dozim të çimentos në mikser (përziers) fillon automatikisht në momentin e fillimit të dozimit të agregatit në mikser (përzierës), apo disa sekonda më vonë. Gjatë kohës së zbrazjes së enës së peshojës me çimento duhet të lëshohet vibruesi, kur procesi kryhet në mënyrë manuale, kur procesi kryhet në mënyrë automatike vibruesi lëshohet në mënyrë automatike.

c. Dozimi i ujit në përzierës si lëndë e parë bazë për përfitimin e betonit bëhet me dozimin e programuar nga pompa për furnizim me ujë kryhet gjithashtu në mënyrë automatike me fillimin e dozimit të çimentos. Pas dozimit të sasisë së caktuar të ujit, ventili dozues automatikisht mbyllet. Nëse janë përmbushë kushtet e procesit për punë automatike (sasia e nevojshme e agregatit në fortin, shtypja e ujit duhet të jetë min. 3at. dhe sasia e nevojshme e çimentos), sasia e prodhuar e betonit për një cikël është 1.5m³, zgjatja e një cikli është përafërsisht 60–90 sek. në varshmëri të llojit të betonit. Gjatë kryerjes së procesit në mënyrë manuale koha e zgjatjes së ciklit varët nga aftësia e punëtorit që operon me pajisjet për realizimin e procesit teknologjik për prodhimin e betonit.


Para se të lëshohen pajisjet për realizimin e procesit teknologjik për prodhimin e betonit, duhet të kryhen këto veprime:

- Duhet të sigurohet sasia e mjaftueshme e agregatit në silose.
- Duhet të sigurohet sasia e mjaftueshme e çimentos dhe duhet hapur ventilin e silosit nga i cili dëshirojmë të marrim çimento.
- Duhet të sigurohet sasia e nevojshme e ujit.
- Duhet caktuar recepturën për kualitetin e betonit të cilin dëshirojmë të e prodhojmë.
- Të caktohet zgjatja e kohës së ciklit të prodhimit të betonit duke u bazuar në recepturën e caktuar. pajisjet mund të funksionojnë në mënyrë automatike me dozim të programuar dhe në mënyrë manuale. Menaxhimi i procesit teknologjik i prodhimit të betonit, kryhet nga pulti komandues i automatizuar i vendosur në dhomën (hapësirën) të caktuar për te. Modulet hyrëse drejtpërdrejt pranojnë sinjalet nga dozatorët dhe peshojat, nëpërmjet sondave për të gjithë komponentët e procesit të prodhimit. Modulet digjitale dalëse shërbejnë për menaxhimin e ventileve elektromagnetikë, motorëve si dhe llampave sinjalizuese. Menaxhimi i tërë procesit të prodhimit bëhet edhe përmes disa monitorëve të vendosur në panelin e komandimit, përmes këtij paneli operatorit i mundësohet të bëjë mbikëqyrjen e tërë procesit dhe recepturat për prodhimin e betonit, me këtë mundësohet matja lehtë e komponentëve të agregatit, çimentos dhe komponentëve tjera shtesë. Për të arritur cilësinë e duhur të betonit bëhet sitja e çimentos me sita standarde dhe përcaktohet kohëlidhja e saj. (Kohëlidhja e çimentos paraqet kohën nga momenti i përzierjes së çimentos me ujë gjer në momentin e fillimit të hidratimit të sajë dhe arritjes së fortësisë përkatëse). Përpos komponentëve të lartcekura për të arritur veçori specifike të betonit, duhet shtuar Aditivët. Në sezonin e dimrit dhe për konstruksione të veçanta shtohen aditivë të cilët e shpejtojnë kohën e ngurtësimit. Aditivi kryesisht shtohet me ujë, ose drejtpërdrejt në mikser. Dozimi i aditivit kryesisht shtohet 2-4% të masës së çimentos. Për realizimin e procesit teknologjik për prodhimin e betonit, me energji elektrike furnizohet nga

rrjeti elektrik, gjithashtu në mungesë të energjisë elektrike kompania posedon gjeneratorin për realizimin e procesit teknologjik.

Përpos pajisjeve të lartë cekura për realizimin e procesit teknologjik për prodhimin e betonit dhe për bartjen e tij gjerë të hargjuesi (konsumatori), kompania disponon edhe këtë mekanizëm: auto mikserë, auto cisternë për bartjen e çimentos, pompë të betonit, kamionë dhe lopata ngarkuese.

Bazuar në kërkesat dhe përvojën e punës në këtë betonier, punët organizohen vetëm në ndërrimin e parë. Fuqia punëtore e angazhuar është e konsiderueshme dhe ka ndikim pozitiv në punësimin e popullatës.






Foto 4. Skema e procesit teknologjik për prodhim të Betonit

5.0. IDENTIFIKIMI DHE PËRSHKRIMI I NDIKIMEVE NË MJEDIS

Analiza e vlerësimit të gjendjes ekzistuese të mjedisit si dhe vlerësimi i ndikimeve të mundshme të cilat janë si pasojë e proceseve teknologjike që do të kryen kompanina „Doni-Beton” SH.P.K., në zonë kadastrale Piranë, komuna Prizrenit. Projekti i ndërtimit të bazës për prodhimin e betonit tregojn se deri te kuantifikimi i të dhënave mund të vihet sipas një analize më gjithëpërfshirëse.

Të gjitha ndikimet e mundshme nuk janë të vlerave të njëjta që të bëhet edhe kuantifikimi i tyre. Në kuadër të procesit të marrjes së pëlqimit mjedisor po hartohet ky raport për të paraqitur disa nga fazt e mundshme të efekteve negative që paraqiten në mjedisin jetësor dhe atë gjatë fazës së funksionimit të tij, po ashtu dhe pas përfundimit të procesit në mënyrë që të paraqiten të dhëna për ndikimet eventuale dhe të mundshme që vijnë nga aktiviteti në fjalë.

Vlerësimi dhe përshkrimi i ndikimeve në mjedis duhet të bëhet për fazën e zhvillimit të aktiviteteve në kompaninë “Doni-Beton” SH.P.K, gjithashtu duhet parapar edhe ndikimet e mundshme në mjedis pas përfundimit të aktivitetit të prodhimit të betonit.

5.1 Ndikimet e mundshme në shëndetin e njerezve

Zhvillimi i aktivitetit nuk ka ndikime në shëndetin e popullsisë së zonës. Ky aktivitet nuk përdorë lëndë të rrezikshme për shëndetin e punonjesve si dhe të popullsisë përreth zones dhe si rrjedhim nuk ndikon negativisht tek ata. Në projekt nuk janë parashikuar ndryshime në popullsinë e zones, të zhvendosjes së saj, për shkak të këtij projekti. Gjatë fazes së funksionimit të betonierës nuk ka ndikime negative në shëndetin fizike dhe mendor të popullsisë, por ka

efekte pozitive në punesimin direkt të popullsisë së zonës duke rritur kështu edhe nivelin e jetesës së tyre.

5.2 Ndikimet në ajër

Referuar natyrës së procesit nuk ka sasi gazesh të emetuara në atmosfere por vetëm përhapje të pluhurit, e cila është e prezente në shesh gjatë kohës së thatë nga lëvizja e mjeteve në kohën e ngarkimit të materialit në bunkeret e depozitimit e ndonjë rast tek peshimi e furnizimi me çimento. Për shmangien e pluhurit bëhet spërkatje me ujë herë pas here në sheshin e punës sidomos në kohë të thatë dhe me ere si dhe hermetizim sa më i mirë në linjën e furnizimit nga silloset në përzieres. Gazet prej mjeteve janë në interval kohor të shkurtera e pa ndonjë ndikim në mjedisin përreth. Nën aktivitetin e prodhimit të betonit ndotja e ajrit mund të vijë nga:

- Ajri mund të ndotet gjatë lirimimit të pluhurit i cili krijohet gjatë zbrazjes së çimentos nga autocisternat dhe mbushja e siloseve me çimento, gjatë sjelljes së çimentos nga silloset në mikser, nga mundësia e lirimimit të pluhurit të çimentos drejtpërdrejt nga vendet lidhëse të gypave përcjellës (transportues) të çimentos.
- Ndotja e ajrit mund të vijë gjatë lirimimit të gazrave nga gjeneratori, nga automjetet e transportit dhe automjeteve tjera të rënda që nevojiten për realizimin e procesit teknologjik për prodhimin e betonit.
- Ajri mund të ndotet po ashtu edhe nga procesi teknologjik për prodhimin e betonit nga ku lirohen grimcat e pluhurit të çimentos, dhe grimcat e pluhurit nga fraksionet e agregatit që përdoret për prodhimin e betonit, grimcat e pluhurave që depozitohen në afërsi të betonierës. Pluhurat kanë përbërje të elementeve kimike që posedon çimentoja dhe vetë lëndat minerale, si të tilla mund të bartin ajri për shkak të relievit dhe kushteve tjera mjedisore deri në distanca më të largëta, kjo situatë e përshkruar, kishte me qenë pa përdorimin e masave për zvogëlimin e pluhurit.

5.3 Ndikimet në ujë

Këto procese teknologjike nuk shoqërohen me shkarkime të lëngjet të rrezikshme. Në këtë proces uji do të dozohet dhe përzihet me inertet dhe çimenton në sasinë e kërkuar për prodhimin e betonit dhe si rrjedhim nuk do të ketë ujë që të dalë nga procesi teknologjik. Ajo sasi e paket e ujit që mund të derdhet kalon në vaska dekantuese dhe me pas i bashkohet linjës së shkarkimit. Ujrat që dalin gjatë larjes së automikserave dhe reshjeve do të orientohen përmes kanaleve përkatese në vaskën e dekantimit dhe me pas për në mjedisin ujor prites. Projekti nuk ndikon negativisht në modelin drenazhues të zonës. Ai do të zbatohet vetëm në një sipërfaqe shumë të kufizuar dhe pa përdorim masiv të ujit. Megjithatë ndikime negative në ujë mund të shkaktohen:

- Uji mund të ndotet nga derivatet dhe vajrat e ndryshme që rrjedhin në tokë nga makinat e cekura më lartë. Derdhja e vajrave ndikon në ujërat sipërfaqësor e me rastin e të reshurave mund të depërtojnë deri në ujërat nëntokësore. Gjithashtu në ndotjen e ujërave ndikon pluhuri i cili bartet me anë të ujërave sipërfaqësor.
- Ujërat e përdorura në procesin teknologjik për prodhimin e betonit paraqesin dëmtim potencial të ujit, nga larja e automikserëve që përdoren për transportimin e betonit e automjeteve transportuese.
- Nga derdhja e ujërave të zeza,
- Nga mbeturinat metalike të korroduara të cilat mund të jenë të depozituara dhe mbeturinat tjera të ndryshme,
- Kompania në këtë fazë posedon sistemin e filtrimit/trajtimit të ujërave, qka është e dobishme për trupin ujor.

5.4. Ndikimet në tokë

Ndotja e tokës në këtë rast karakterizohet me dy faza të ndotjes: faza parë përfshin periudhën gjatë ndërtimit të betonierës kurse faza e dytë periudhën gjatë procesit të prodhimit të betonit. Gjatë fazës ndërtuese ndikim negativ në tokë është paraqitur si rezultat i deponimit të dheut/materialit të gërmuar për bazamente, hapja e sipërfaqeve për bazamentin, po ashtu efekt negativ kemi edhe nga mbeturinat e ngurta të cilat janë krijuar nga materialet ndërtimore gjatë fazës së ndërtimit, mbeturinat e ngurta komunale të cilat i krijojnë punëtorët. Ndotja mund të vije edhe nga mbeturinat e lëngëta të cilat shkaktohen nga derdhja e vajrave dhe derivateve të ndryshëm nga mjetet transportuese që transportojnë materialin ndërtimor. Gjatë fazës së aktivitetit për prodhimin e betonit, ndikime negative në mjedis paraqiten në tokë në këtë mënyrë:

- Ndikimet nga mbeturinat e lëngëta të cilat shkaktohen nga derdhja e vajrave dhe derivateve të ndryshëm nga mjetet punuese gjatë furnizimit dhe ndërrimit të tyre, gjatë pëlcitjes të gypave hidraulik të mjeteve punuese,
- Ndikimet nga mbeturinat e ngurta dhe lëngëta që krijohen nga larja e auto-mikserëve, dhe automjetet tjera transportuese,
- Ndikim tjetër në tokë paraqitet edhe nga deponimi i materialeve të ndryshme të ngurta metalike të cilat mbesin nga riparimi dhe ndërimi pjesëve të prishura të pajimeve prodhuese të betonierës, të cilat deponohen në sipërfaqet operationale afër betonierës,

- Depozitimi i pluhurave që krijohet nga proceset teknologjike paraqesin efekt mjaftë të dëmshëm në hapësirar përreth, e po ashtu edhe ngjeshja e tokës që vie si pasojë e makinave punuese dhe te tjerave gjatë punës se nevojshme në atë vend.
- Ndikimet negative nga mbeturinat e ndryshme organike dhe jo organike të cilat i krijojnë punëtorët.

5.5 Ndikimet në klimë

Gjatë zhvillimit të projektit nuk priten ndryshime të dukshme klimatike, si në drejtim të përmiresimit ashtu edhe në atë të përkeqësimit të saj. Nuk do ketë ndryshime në temperature, në drejtim të erës, në sasinë e reshjeve. Pra, kryerja e këtij aktiviteti nuk ndikon fare në kushtet klimatike të kësaj zone.

5.6 Nivelet dhe ndikimet e zhurmave

Ndikimet e zhurmave gjatë fazës funksionale të bazës për prodhimin e betonit do të vijne nga mjetet që do të sjellin lëndet e pare në linje, pajisjet e instaluar për përzierjen e agregateve për prodhimin e betonit të gatshëm sipas markave të caktuara. Niveli i zhurmave të këtyre mjeteve transportuese është i atij niveli që nuk influencon si për te punësuarit dhe për banoret dhe gjallesat për rreth tij. Koha në të cilën do të jenë të pranishme këto zhurma është vetëm gjatë ditës, mëqenëse do punohet vetëm me një turn/ndërrim. Niveli i zhurmave të këtyre mjeteve në largësi nuk do të jetë i madhë dhe do të jetë konform normave në fuqi, megjithatë duhet bërë analizat përkatëse edhe për matjen e nivelit të zhurmës, sidomos për shkak të banoreve të cilët jetojnë në afërsi dhe që mund të paraqitet pengese, nëse zhurma kalon kufijtë e lejuar.

5.7. Ndikimi në Peisazh

Lokacioni ku do të vendoset betoniera dhe objektet e saj përcjellëse nuk është vend industrial i zhvilluar, është kryesisht tokë bujqësore, andaj për zhvillimin e kësaj veprimtarie është bërë degradim i konsiderueshëm natyror. Gjatë fazës së ndërtimit peizazhi do të pësojë një dëm të konsiderueshëm, i cili me masat që do të merren në mbarim të jetë-gjatësisë së projektit, peizazhit do ti kthehet pamja në harmoni me gjendjen e përafërt të mjedisit rrethues. Këto masa do të arrihen me aplikimin e rikultivimit.

5.8. Ndikimi në florë dhe faunë

Për shkak të proceseve operuese që zhvillohen në betoniere në gjatësinë kohore të operimit dhe në sipërfaqet operuese për rreth betonierës flora tërësisht është shkatërruar, e cila propozohet të gjelbërohet me aq mundësi dhe hapësirë që të këtë, poashtu domosdoshmërisht duhet të rikultivohet pas përfundimit të punëve prodhuese. Fauna nuk do të dëmtohet fizikisht për arsye se do të largohen nga regjioni i veprimtarisë prodhuese dhe do të zhvillohet në terrenin e

përafërt që i përshtatet faunës, pa anashkaluar faktin se një pjesë të botës shtazore i janë shkatrruar foletë e tyre, kryesisht zvarranikë. Gjatë kohës kur pushon aktiviteti prodhues fauna prapë kthehet për tu zhvilluar në hapësirat e mëparshme.

5.9. Ndikimet në vendbanime dhe popullatë

Ndikimi negativ në vendbanimet përreth është minimal, pasi që edhe nuk ka qenë nevoja të bëhet zhvendosja e ndonjë objekti apo ndërtese që të krijohet hapësira e nevojshme për ndërtimin e objektit. Kjo falë largësisë dhe pozitës së përshtatshme ku ndodhet lokacioni i betonierës. Zhvillimi i aktivitetit në fjalë në këtë zonë edhe pse jo të zhvilluar, ka rëndësi për popullatën e këtij lokaliteti. Parashihet punësim i disa punëtorëve kryesisht nga popullata vendase nga ana e pronarit të kompanisë, megjithëse mjaftë modest do të ndikojë pozitivisht edhe në ekonominë lokale.

5.10 Ndikimet në ekonomi

Sa i përket ndikimeve ekonomike ky projekt do të sjell efekte direkte në punësimin e popullsisë së zonës gjatë funksionimit të tij, pra do të rrisë tregun e punës si rrjedhim do të rritet edhe mireqenia e nivelit të jetesës së popullsisë së zonës, gjithashtu duke qenë një aktivitet i prodhimit, tregtimit dhe shpërndarjes së betonit që është një element që i vjen në ndihmë industrisë së ndërtimit në përgjithësi.

5.11. Ndikimet në raste të aksidenteve mjedisore

Pasi që aktiviteti i betonierës dhe pajisjet tjera përcjellëse do të janë mirë të projektuara, të vendosura dhe të monitoruara nga ekspertë, pastaj veprimtaria në fjalë nuk funksionon me materie të rrezikshme për mjedisin, konkludojmë se aksidente mjedisore të mëdha nuk mund të ndodhin. Aksidentet të cilat mund të ndodhin, mund të jenë të natyrës së ndryshme dhe mund të ndodhin në çdo kohë gjatë realizimit të procesit teknologjik si:

- Nga rrjedhjet e ndryshme të lëndëve djegëse dhe lubrifikuese,
- Nga mekanizmi punues,
- Nga mundësia e pëlcitjes së gypave hidraulik,
- Nga aksidentet e mundshme në komunikacion gjatë transportit të agregatit, çimentos dhe betonit,
- Nga aksidentet e mundshme në komunikacion gjatë kyçjes së automjeteve transportuese nga baza e betonit në rrugën kryesore,
- Nga aksidentet e mundshmenë rast të vërshimeve eventuale,

6.0. MARRJA E MASAVE PËR PARANDALIMIN DHE ZVOGËLIMIN E NDIKIMEVE

Masat zbutese të ndikimeve negative konsistojnë në marrjen e masave për uljen e ndotjeve gjatë procesit të prodhimit të betonit, si të pluhurit në ajër, zhurmave, erozionet si dhe uljen e efekteve negative hapësinore në territor, faun dhe flore.

6.1 Masat për emetimet në ajër

Aktiviteti për prodhimin e betonit nuk sjell emetime të gazeve në atmosfere sepse nuk përdore lënde djegëse gjatë zhvillimit të aktivitetit të tij prodhues. Lënda djegëse përdoret vetëm nga mjetet e transportit të lëndeve të para si dhe produktit përfundimtar (betonit). Sillosat janë të mbyllur në mënyrë hermetike. Në linjë është instaluar filtri i pluhurave të çimentos në mënyrë që pluhuri të mos dalë në atmosferë. Pra, i gjithë procesi është një cikël i mbyllur dhe nuk emeton pluhura. Përsa i përket pluhurave që krijohen gjatë procesit të ngarkimit apo shkarkimit të lëndeve të para nga ana e kompanisë në mënyrë periodike sidomos në kohë të thatë do të bëhet lagia/spërkatja e territorit me ujë për shmangien e pluhurit. Transportuesit janë prej gome të hermetizuar si dhe në linjë do të instalohen filtra për pluhurat në mënyrë që të mos ketë emetim të tyre në atmosferë. Punonjësit do të jenë të pajisur me maskat përkatëse për mbrojtjen ndaj tij. Përreth linjës do të bëhet sistemimi i ambientit për qëllim mbrojtjen e peizazhit duke bërë mbjelljen e pemëve me gjelberim të përhershëm si dhe me lule dekorative. Nga ana e personelit të kompanisë do të tregohet një kujdes i veçantë për mirëmbajtjen e tyre.

6.2 Masat për shkarkimet në ujë

Siç është theksuar edhe më sipër ky proces nuk shkarkon në mjedis ujor prirës ujëra të ndotura nga procesi i prodhimit të betonit. Uji përdoret si element përzierës në beton sipas recepturave të caktuara dhe nuk ka tepërca të tij. Ujërat që dalin gjatë larjes së autobetonierëve dhe reshjeve orientohen përmes kanaleve përkatëse në vasken e dekantimit dhe më pas për në mjedisin ujor prirës. Në mënyrë periodike nga ana e kompanisë do të bëhet pastrimi i kanaleve orientues si dhe vaskes së dekantimit. Fraksionet e inerteve që dekantohen aty rifuten në procesin e prodhimit të betonit. Për levizjen e ujerave të shiut duhet ndërtuar sistemi i drenazhimit ndërsa përsa i përket ujerave të zeza ato i bashkohën sistemit të kanalizimit.


Për të parandaluar e zvogëluar sasinë e ndikimeve negative në ujë të cilat i kemi cek më lart duhet ndërmarr këto masa:

- Në lokalitetin e betonierës duhet të bëhet sistemi për grumbullimin dhe bartjen e ujerave të ndotura të krijuara nga procesi i prodhimit, nga larja e automjeteve transportuese,

automikserëve për transportimin e betonit dhe automjeteve tjera të rënda, ujërave nga të reshurat atmosferike.

- Duhet rregulluar sistemin gypor për bartjen e ujërave të ndotura të cilat duhet të dërgohen për trajtim në puse sedimentuese për pastrimin e ujërave të ndotur me grimca të ngurta.
- Kolektorët duhet të rregullohen në pozicionet e caktuara me qëllim që e tërë sasia e ujërave industriale dhe e të reshurave atmosferike nga platot dhe nga tëra sipërfaqet funksionale të grumbullohen dhe të orientohen në puset sedimentuese e pastaj në seperator. Duhet të ndërtohen tre puse sedimentuese në atë mënyrë që të mund të sedimentohen grimcat e ngurta, e pas trajtimit të ujërave në puset sedimentuse, uji të orientohet për trajtim të mëtutjeshëm në seperatorin për pastrimin e ujërave të ndotur nga derivatet dhe vajrat të cilat kanë rrjedh në sipërfaqet operationale, nga pajisjet e punës, pastaj ujërat e trajtuara nga seperatori të lirohen në recipient.
- Seperator duhet të rregullohet në at mënyrë që të mundë të kontrollohet rregullisht uji i cili pastrohet dhe të merren mostrat e ujit i cili pastrohet.
- Duhet rregullisht të pastrohen puset sedimentuese dhe seperatori. Mbeturinat të cilat nxjerrën nga seperatori pas pastrimit të tij duhet të dërgohen në deponin regionale, mbeturinat të cilat nxjerrën nga puset sedimentuse do të përdoren si material riciklues të rikthehen në proces të prodhimit të betonit.
- Ujërat e zeza duhet së pari të trajtohen në gropën septike e cila duhet të ndërtohet në varshmëri me numrin e punëtorëve, dhe pas trajtimit të lëshohen në recipient të pastërta.
- Gropa septike duhet të pastrohet nga kompanitë e licencuara. Rekomandohet që të ndërtohet një rezervuar me qëllim të mbajtjes së ujërave të trajtuara, uji i trajtuar (pastruar) do të rikthehet në procesin teknologjik, kështu që do të mbyllet cikli i trajtimit dhe furnizimit me ujë industrial dhe do të parandalohet shkarkimi i ujërave. Do të ekzistojnë dy mundësi të shkarkimit të ujërave të trajtuara njëra drejtpërdrejt nga seperatori në recipient, tjetra mundësi prej seperatorit në rezervuar, prej nga do të shkarkohet në recipient nëse nuk nevojitet për procesin teknologjik.

Shema teknologjike e trajtimit të ujrave



6.3 Masat për mbrojtjen e tokës

Mbetjet e ngurta që vijnë si rezultat i projektit janë dherat që rezultojnë nga gjurmimet e bëra për nivelim të territorit për instalimin e linjes së prodhimit të betonit. Keto dhera depozitohen në një vend të veçantë në mënyrë që të ripërdoren për rehabilitimin e zones. Gjatë procesit të funksionimit ky aktivitet nuk gjeneron mbetje të ngurta në formë sterileshe të dëmshme për mjedisin, fraksionet e inerteve hidhen me masen e duhur në autobetoniere për procesin e përzierje se betonit, ndërsa masa e ngurtë që dekantohet në gropën dekantuese rifuten në proces. Mbetje të tjera të cilat dalin nga aktiviteti i përditshëm i punetoreve do grumbullohen në kontejner dhe me pas largohen për në vendin e caktuar nga pushteti lokal i zones konform kërkesave të përcaktuara.

Për të parandaluar dhe zvogëluar sasinë e ndikimeve negative në tokë gjatë fazës së ndërtimit të bazës së betonit duhet të merren këto masa:

- Dheu i grupuar duhet të shfrytëzohet për rrafshimin, planifikimin e terenit i cili duhet të mbillet, pjesa tjetër e dheut duhet të dërgohet në deponi regjionale,
- Të gjitha mbeturinat e ngurta të cilat krijohen nga materialet ndërtimore duhet të klasifikohen sipas përbërjes dhe llojit të tyre, dhe të deponohen në vende të posaçme, ato të cilat nuk përdoren dhe shitën për nevojë komerciale duhet të dërgohen në deponi regjionale.
- Mbeturinat e ngurta komunale të grumbullohen, klasifikohen dhe të vendosen në kontejnerë të posaçëm të pajisur me kapak për mbulim, kontejnerët duhet të sigurohen për deponimin e të gjitha llojeve të mbeturinave të klasifikuara në bazë të rregullave dhe kushteve të përcaktuara me Ligj të mbeturinave, pas mbushjes së kontejnerëve

përmes ndërmarrjeve për menaxhimin e mbeturinave, këto mbeturina të dërgohen në deponin e qytetit.

- Vaji i makinave ngarkuese dhe transportuese që nevojiten për ndërtimin dhe funksionalizimin e betonierës të ndërrohet në vende të caktuara dhe të izoluara për mos depërtimin e tyre në tokë, vajrat e përdorura duhet të deponohen në enë të posaçme, dhe pastaj tu dorëzohen ndërmarrjeve të licencuara për grumbullimin e vajrave të përdorura.

Për të parandaluar e zvogëluar sasinë e ndikimeve negative në tokë gjatë fazës së operimit të bazës së betonit duhet të merren këto masa:

- Duhet në mënyrë të rregullt të mirëmbahen stabilimentet që nevojiten për realizimin e procesit për prodhimin e betonit, të mirëmbahen filtrat në siloset e çimentos, të mirëmbahen gypat të cilët përdoren për përcjelljen e çimentos prej auto-cisternave gjer në silos dhe prej silosit gjer në pajisjet për prodhimin e betonit, të gjitha pjesët lidhëse të gypave të puthiten mirë me qëllim të pengimit të lirimit të pluhurit.
- Duhet të merrën masat e nevojshme për mos lëshuarjen e pa kontrolluar të derivateve dhe vajrave nga makinat dhe pajisjet prodhuese.
- Të bëhet betonimi i platos ku janë të vendosura pajisjet për prodhimin e betonit dhe sipërfaqet tjera operationale.
- Vaji i makinave të ndërrohet në vende të caktuara të betonuara dhe të izoluara për mos depërtimin e tyre në tokë.
- Të bëhet betonimi i platos ku deponohen mjetet themelore dhe sekondare që nevojiten për punët në ndërtimtari të ultë dhe lartë.
- Të gjitha mbeturinat e ngurta të cilat krijohen në lokacionin e betonierës duhet të grumbullohen dhe klasifikohen sipas përbërjes dhe llojit të tyre, ato metalike të deponohen në vende të posaçme, ato të cilat nuk përdoren për nevoja të kompanisë ti shiten kompanive të licencuara.
- Mbeturinat e ngurta komunale të grumbullohen dhe vendosen në kontejner të posaçëm të pajisur me kapak për mbulim, me transport vetanak apo nëpërmjet ndërmarrjeve për menaxhimin e mbeturinave, këto mbeturina të dërgohen në deponin regionale.
- Vajrat motorike dhe ato të mirëmbajtjes së pajimeve të betonierës duhet të deponohen në enë të posaçme, dhe të u dorëzohen ndërmarrjeve të licencuara për grumbullimin e vajrave të përdorura.
- Të bëhet betonimi apo asfaltimi i rrugës që lidhë betonierën me rrugën kryesore.

- Sipërfaqet jo funksionale të mbjellën me bimë gjelbëruese, si dhe të mbillen drunjt dekorativ gjeth mbajtës.

6.4. Masat për mbrojtjen e florës dhe faunës

Sipas analizave të bëra deri tani në lidhje me ndotjen e ajrit, ujit dhe tokës mund të vie deri te ndikimet në florë dhe faunë. Mirëpo sipas gjendjes faktike në teren respektivisht në lokacionin e caktuar nuk kemi zhdukje të vegjetacionit pos nga sipërfaqet manipulative, nga sipërfaqja nën pajisjet e bazës të betonit kjo do të thotë se kemi të bëjmë me koncentracion të vogël të polutantëve. E njëjta do të vlente edhe për faunën që do të thotë se nuk pritet të ketë ndikime negative. Kompania nuk duhet të deponoj pa kontroll mbeturina në vende të ndryshme, por ato duhen të deponohen në vende me destinacion të caktuar. Në raste të lajmërimit të zjarrit menjëherë të merren masa për neutralizimin e tij në mënyrë që të mos dëmtohet bota bimore. Pajisjet kundër zjarrit duhen të ruhen në mënyrë të veçantë. Për mbrojtjen e botës shtazore kompania duhet të tregoj kujdes duke kufizuar lëvizjet e të punësuarve jashtë zonës operuese dhe të kenë kujdes në nivelin e zhurmës, kualitetin e ajrit, ujit, etj

6.5. Masat e marura për mbrojtjen nga zhurma

Për të parandaluar dhe monitoruar dëmin e shkaktuar nga zhurma, duhet të bëhen matjet e zhurmës në përputhje me ligjet dhe rregullat mbi mbrojtjen nga zhurma. Matjet zakonisht bëhen në afërsi të objekteve të banimit, por meqë në afërsi nuk ka ndonjë shtëpi banimi, kjo gjë nuk është dhe aq e nevojshme. Për vlerësimin e rezultateve të fituara nga matjet duhet ti krahasojmë me vlerat e lejuara me standarde për vendet ku jetojnë dhe punojnë njerëzit. Në raste se zhurma e mesit nga matjet tejkalon atë të lejuarën atëherë duhet të merren të gjitha masat që niveli i zhurmës të ulët në nivelin e lejuar sipas rregullave në fuqi. Në varshmëri nga fazat e procesit të punës duhet edhe të punësuarit në ato vende të punës të përdorin mjete mbrojtëse kundër zhurmës.

Masat që do të merren për minimizimin e zhurmave nga ana e shoqërisë janë:

- Makinat e transportit dhe pajisjet gjatë fazës së ndërtimit do të jenë bashkekohore që plotësojnë standartet shtetërore, të pajisura në marmita selenciatores të pakësimit të zhurmave.
- Për të ulur me tej ndikimin nga zhurmat punetoret detyrimisht do të përdorin pajisjet e mbrojtjes në punë “kufje”.

6.6 Masat e marura për mbrojtjen nga rreziqet aksidenciale

Duhet të bëhet plani i intervenimit për raste të aksidenteve ekologjike. Duhet të bëhet plani i mbrojtjeve nga zjarri. Duhet i tërë oborri i betonierës të thuret me mure nga betoni me qëllim

të marrjes së masave të sigurisë ndaj vërshimeve eventuale. Të merren të gjitha masat për evitimin e derdhjes së derivateve të naftës dhe vajit nga makinat transportuese dhe ngarkuese si dhe pajisjet tjera. Të merren të gjitha masat e sigurisë për kycjen e automjeteve transportuese në rrugën magjistrale pa penguar komunikacionin. Të merren të gjitha masat e sigurisë konform ligjit për siguri në punë, mbrojtje të shëndetit të punësuarve dhe mjedisit të punës.

Sigurimi teknik dhe mbrojtja në punë –Aktiviteti për prodhimin e betonit nuk përdor lëndë të demshme dhe të rrezikshme si për mjedisin ashtu edhe për punonjesit. Lëndet e para që futen në proces nuk pesojnë ndryshime kimike. Për shmangien e aksidenteve nga pajisjet dhe makinerit tregohet një kujdes i vecantë nga punonjesit për mirembajtjen e gjendjes së tyre teknike si dhe zbatohen me rigorozitet kushtet e sigurimit teknik. Gjithashtu në mënyrë periodike punonjesit instruktohen për rreziqet në punë dhe masat e menyrat për parandalimin e tyre. Për të krijuar një ambient pune optimal dhe funksional kompania do të pajisë të gjithë punonjesit që do të punojnë në linjen e prodhimit të betonit me uniformat dhe mjetet mbrojtëse përkatëse. Regulloret e Teknikës së Sigurimit, nga ana e drejtuesit teknik dhe shoqërisë, do të zbatohen në çdo proces pune të përcaktuar në plan-organizimin e kryerjes së proceseve të punës të hartuar nga drejtuesi teknik i punimeve dhe të miratuar nga drejtuesi i shoqërisë, i cili do të përmbajë:

- Plan organizimi i punës hartohet nga drejtuesi teknik.
- Drejtuesi teknik i punimeve ose personi i ngarkuar, do të bëjë kontrollin teknik për ecurinë dhe mbarëvajtjen sa më të mirë të proceseve të punës.
- Drejtuesi teknik i punimeve do të kryejë instruksione të rregullta mujore e tre mujore për punonjesit.
- Kujdes i vecantë do të tregohet në krijimin e kushteve të punës sa më konforte për punonjesit.

7.0 PLANI I MENAXHIMIT DHE MONITORIMIT TË MJEDISIT

Monitorimi i mjedisit është një proces i cili duhet të përmbajë një program sa më të plotë për të trajtuar dhe për të përballuar të gjitha problemet që mund të lindin nga zbatimi i këtij projekti dhe për të zvogëluar këto ndikime. Menaxhimi mjedisor është një siguri dhe një mbështetje për zbatuesit e projektit për çdo avari të papritur që mund të ndodhë dhe gjithashtu mund të përdorin një skemë të gatshme për të përballuar këto probleme që mund të lindin gjatë fazave të zhvillimit. Skema e menaxhimit mjedisor përmban këto objektiva afatgjata:

- Mbështetje e plotë me legjislacionin dhe politikën e kompanisë,

- Përzgjedhje te politikave me te mira mjedisore dhe te performancave te ndërtuara rreth parimit dhe përmirësimit të vazhdueshëm te gjendjes se mjedisit,
- Bashkepunim te plote te mjedisit me projektin,
- Praktika me te mira për cdo nderhyrje mjedisore për të rritur ne kete menyre vlerat e efektivitetit,
- Inkurajimi për të arritur performancën e lartë nga punonjësit dhe kontraktorët individualë,
- Për te siguruar standardet për planifikimin e përgjithshëm, funksionimin, kontrollin dhe rishikimin,
- Menaxhimi duhet të paraqese prioritetet mjedisore,
- Të jetë i zbatueshëm në të gjitha fazat e projektit,
- Para zbatimit te projektit duhet te zhvillohen konsultimet e para me banoret e zones dhe autoritetet vendore dhe te merren ne kosiderate cdo lloj ndihme vullnetare.

8.0. MONITORIMI DHE RAPORTIMI

Investitori është i obliguar që të bëj monitorimin e përhershëm të ndikimeve negative në mjedis e posaçërisht monitorimin e tokës, ajrit dhe zhurmës. Këto ndikime mund të jenë relativisht minimale në mjedis pas marrjes së masave mbrojtëse, dhe si të tilla mund të monitorohen. Për këtë arsye parashihet një program monitorues për degradimet e tokës, kualitetin e ajrit dhe ujit. Duhet të bëhet matja e kualitetit të ajrit (matja e emisioneve) dhe zhurmës gjatë punës maksimale të pajimeve, matja duhet bërë te shtëpitë më të afërta. Monitorimi i ajrit dhe ujit duhet të bëhet me marrjen e mostrave dhe kryerjen e analizave në institute të akredituara për llojin e analizës. Të bëhet kontrollimi i përhershëm i seperatorve si dhe i gropës septike, dhe zbrazja e tyre të bahet me kohë. Kontejnerët e mbeturinave të zbrazën rregullisht. Të respektohen të gjitha rregullat teknike dhe kërkesat lidhur me sigurinë ndaj zjarrit, sigurinë ne punë dhe mbrojtjen e mjedisit.

Raportimi do të kryhet nga personi përgjegjës i autorizuar nga menaxhmenti, gjegjësisht nga ekspertet e kompanisë. Në raport, eventualisht do të përfshihen të dhënat për monitorimin e te gjitha parametrave te cilët do të jenë kërkuar në Pëlqimin Mjedisor, përkatësisht lejen mjedisore të lëshuara nga MMPHI.

7. Monitorimi

Ndikimet direkte nga aktiviteti i prodhimit të betonit, bazuar në vlerësimet e ndikimit në mjedis janë ndikimet në tokë, ajër dhe ujë. Këto ndikime janë relativisht minimale në mjedis pas marrjes së masave për zvogëlimin e këtyre ndikimeve, dhe si të tilla mund të monitorohen. Për këtë arsye parashihet një program monitorues për degradimet e tokës, kualitetin e ajrit dhe ujit. Duhet të bëhet matja e kualitetit të ajrit (matja e emisionit) gjatë punës maksimale të pajimeve, matja duhet bërë të shtëpitë më të afërta. Monitorimi i ajrit dhe ujit duhet të bëhet me marrjen e mostrave dhe kryerjen e analizave në institute adekuate, duhet bërë krahasimin e rezultateve me rezultatet e më hershme dhe vlerat e caktuara me ligjet në fuqi, rezultatet të raportohen në Ministri të Mjedisit Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës sipas kërkesës së tyre.

9.0 MARJA E MASAVE REHABILITUESE PAS PËRFUNDIMIT TË PROJEKTIT

Pas përfundimit të jetë gjatësisë së projektit e kjo varret nga vjetërsia e makineris dhe interesi i investitorit për të vazhduar aktivitetin. Pas këtij afati pajisjet e duhet të çmontohen e të vendosen në një lokalitet tjetër apo në bazë të leverdis së kompanisë të shitën si material i vjetruar. Bazamentet nga betoni duhet të shkatërrohen, imtësohen dhe të dërgohen në deponit regionale. Rikultivimi si proces mjedisor realizohet në marrëdhënje në tri faza.

- Faza teknike
- Faza agro-teknike dhe
- Faza biologjike

9.1. Faza e teknike e rikultivimit

Faza e teknike e rikultivimit përfshin aktivitetet e përgatitjes së karrierës me qëllim të rregullimit të terrenit, gjegjësisht mbushjes, shtrirjes së sterilit në sipërfaqen e karrierës e cila duhet të jetë e përshtatshme për shtrirjen e humusit.

9.2 Faza e rikultivimit agro-teknik

Masat agro-teknike të cilat duhet të kryhen janë:

Shpërndarja e pjesës humusore me trashësi adekuate 50 cm, në tërë sipërfaqen e përgatitur për rikultivim. Me qëllim të rritjes së stabiliteti dhe përfitimit të kompaktësisë duhet të bëhet aktiviteti i ngjeshjes. Pas kryerjes së këtij operacioni duhet bërë hapja e kanaleve, apo birave për mbjelljen e fidanëve. Gjerësia dhe thellësia e birave duhet të jetë e gjerë sa është shtrirja e lirë e sistemit rrënjësor të bimës. Në gropat e hapura duhet bërë plehrimin me qëllim që fidanët në procesin fillestar të vegjetacionit të kenë materie ushqyese të mjaftueshme për zhvillim.

Mbjellja e fidanëve duhet bërë në sezonin e vjeshtës kur sasia e lagështisë është më e madhe me qëllim që bima të ketë fillim të suksesshëm të vegjetacionit në stinën e pranverës.

Investitori obligohet që fidanët të cilat mbillen të kenë çertifikatën shëndetësore për gjendjen e tyre nga prodhuesi i licencuar. Procesi i mbjelljes duhet bërë duke hequr pjesët e rrënjëve dhe pjesët tjera të dëmtuara. Para mbjelljes së fidanëve, rrënjët e tyre duhet të zhyten në solucion të freskët prej argjile duke bërë një kombinim i cili shërben si ushqim fillestar për bimën. Përgatitja e kushteve në këtë mënyrë, bima është e gatshme të mbillet.

Dimensionet e gropave për mbjelljen e bimës duhet të jetë 40 x 40 cm

Distanca e ndërmjet bimëve në rendë duhet të jetë 2 m.

Distanca në mes rendeve duhet të jetë 3 m.

Drejtimi i mbjelljes së rendeve duhet të jetë VJ-PL

$$Nrf = S / a \times b$$

Nrf- numri i fidanëve

S-Sipërfaqja (m²)

a-distanca e fidanëve (m)

b- distanca e filaneve në mes rendeve (m)

9.3 Faza e rekultivimit biologjikë

Me qëllim të përmbushjes së kërkesave ekologjike dhe përshtatshmërisë së ambientit bimët të cilat i rekomandohet investitorit të mbillet është Bredhi i zi, është bimë halore gjethëmbajtëse që i përshtatet kushteve klimatike të rajonit, në këtë lokacion. Mbjellja e këtij druri do të përmirësojë pamjen vizuale, peizazhin, freskon ambientin, do të ketë pamje me të bukur, dhe shton sipërfaqen e pyllëzuar që është e mangët në këtë zonë. Bredhi i zi është bimë rezistuese ndaj ndryshimeve klimatike temperaturave ekstreme dhe është rezistues ndaj dëmtuesve biologjik. Edhe pse janë propozuar këto bimë, duhet të bëhet konsultimi me autoritetet komunale dhe të Ministrisë së bujqësisë dhe pylltarisë. Investitorit i rekomandohet që pas mbjelljes së fidanëve të përkujdeset për rritjen e fidanëve të mbjellura.

10. Kontrolli i emisioneve pas përfundimit të aktiviteti prodhues të betonit

Me përfundimin e aktivitetit të bazës për prodhimin e betonit dhe aktivitetëve tjera teknologjike, respektivisht pas përfundimit të jetës së veprimtarisë dhe rehabilitimit të ngastrave për qëllime tjera, nuk është e nevojshme dhe nuk parashihet monitorimi i ajrit, ujit dhe tokës apo ndikimet tjera në mjedis për shkak të bazës për prodhimin e betonit. Kompania, ka për detyrë të bëjë monitorimin e sipërfaqeve të rekultivuara, posaçërisht pjesës së pyllëzuar për një kohë të caktuar.

11.0 KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

11.1 Konkluzione

Bazuar në analizën e bërë mbi vlerësimin e ndikimit në mjedis konkludojmë se zbatimi i projektit nuk do të ketë pasoja negative të mundshme në mjedisin e zonës. Ndikime minimale do të ketë vetëm në ndryshimin e peizazhit të sipërfaqes ku do të instalohet linja e bazës për prodhimin e betonit.

- Procesi teknologjik i prodhimit të betonit nuk shoqërohet me shkarkime të lëngta të rrezikshme. Ujerat që përdoren në linjën e prodhimit të betonit thuajse nuk kanë tepër sasi se dozohen në sasi të përcaktuara, sasi të minimale shkarkohen vetëm pas dekanitimit të masës së ngurtë në vasken dekantuese. Meqenëse lëndet e para të përdorura për prodhimin e betonit janë inerte, këto ujera nuk kanë elemente që mund të kontaminojnë mjedisin ujor prites, sipërfaqësore, nentokësore apo tokën.
- Përreth perimetrit të bazës së betonit do të ndërtohen kanalet drenazhues për ujera atmosferike në mënyrë që të shmangët fenomeni i erozionit.
- Ky aktivitet nuk përdorë lëndë të rrezikshme për shëndetin e punonjësve si dhe të popullsisë përreth zonës dhe si rrjedhim nuk ndikon negativisht tek ata.
- Ky projekt nuk sjell emetime të gazeve në atmosfere. Gjatë procesit të ngarkimit – shkarkimit të materialit në bunkere, bëhet pluhur i lehtë dhe drejtuesit e kompanisë do të marrin masa për spërkatjen me ujë, për paisjen e punëtorëve dhe shoferëve të mjeteve të rënda me mjetet e domosdoshme për mbrojtjen nga pluhuri, kapele mbrojtëse, doreza pune, maska për mbrojtjen nga pluhuri.
- Niveli i zhurmave që vijnë nga automjetet dhe pajisjet e tjera janë brenda normave të lejuara. Nuk përbëjnë problem shqetësues për punonjësit dhe as për banorët e zonës përreth që janë në një distance të konsiderueshme.
- Furnizimi me ujë do të sigurohet nga pusi i shpuar brenda hapësirës së bazës së betonit.
- Furnizimi me energji elektrike do të sigurohet nga rrjeti ekzistues që mbulon zonën duke plotësuar të gjitha kushtet teknike.
- Zona ku do zbatohet projekti nuk njihet si zone e mbrojtuar me vlera arkitektonike dhe kulturore, pra nuk kemi ndryshime apo demtime të saj duke qenë se nuk ekziston në këtë territor.
- Për një punë sa më optimale në impiant zbatohen rregullat e sigurimit teknik dhe punëtorët e shoferët njihen me këto rregulla në mënyrë periodike nga drejtuesit teknik të kompanisë.

11.2 Rekomandime

Duke ditur se gjatë proceseve të punës në linje emetohen në mjedis pluhur i lehtë, ka zhurma të makinerive, ndërsa për të rritur sigurinë në punë të punonjësve dhe për të ulur në maksimum impaktin në mjedis, duhet të:

- Të bëhet rregullisht monitorimi i gjendjes teknike të automjeteve.
- Të bëhet monitorimi periodik i emetimit të zhurmave në mjedis.
- Të bëhet vendosja dhe ndërrimi i filtrave në mënyrë periodike.
- Të bëhet monitorimi periodik i emetimit të pluhurit në ajër.
- Të njihen punonjësit periodikisht me rregullat e sigurimit teknik.
- Të ndërtohet kanali drenazhues rreth gjithë sipërfaqes operationale (bazës së betonit) me qëllim të grumbullimit të ujrave të shpërlarjes së betonierës, automikserave dhe pompes si dhe lidhja e këtij kanali me kolektor dhe pusët sedimentuese.
- Të ndërtohen pusët sedimentuese (dysHEMEJA dhe muri për rreth pusit sedimentues të jetë e betonuar).
- Të krijohet sistemi për kthimin e ujit në proces teknologjik.
- Kontenieret me aditiv të vendosen në vaska speciale me kapacitet të njëjtë të kontainerit.
- Të pastrohen dhe mirëmbahen kanalet e drenazhimit të ujrave përreth perimetrit të linjes si dhe pusët sedimentuese.
- Të kontrollohet kompletimi me mjete mbrojtëse nga zjarri.
- Të respektohen normat e teknikes së sigurimit në punë nga punëtorët.

Pas punimit të këtij raporti të VNM-së, mund të konkludohet se aktiviteti i bazës për prodhimin e betonit, nuk ka potencial të rrezikimit të shëndetit të njerëzve, gjithashtu ndikimet në tokë, ujë, ajër dhe peisazh, pas identifikimit dhe zbatimit të të gjitha masave mbrojtëse të rekomanduara në këtë raport, konstatohet se ato mund të minimizohen në nivel të lakmueshëm edhe të eliminohen në fazën e rehabilitimit të hapësirave të degraduara. Gjithashtu, është paraparë që paralel me bazën për prodhimin e betonit, të bëhet edhe rikultivimi i sipërfaqeve të degraduara aty ku lejojnë mundësitë e operacioneve teknologjike të bazës për prodhimin e betonit.

Mendojmë se këto të dhëna janë të mjaftueshme për raport të VNM-së dhe i mundësojnë Ministrisë së Mjedisit Planifikimit Hapësinor dhe Infrastruktues (MMPHI-së) dhënien e mendimit pozitiv për Pëlqimi Mjedisor sipas kërkesës së pronarit të biznesit “Doni-Beton” shpk, z. Naser Elshani, për ndërtimin e bazës për prodhimin e betonit në zonën kadastrale Piranë, Komuna e Prizrenit.

LITERATURA

1. Plani Zhvillimor Komunal i Komunës së Prizrenit
2. Harta zonale e komunës së Prizrenit (HZK) për periudhën 2020-2028
3. MMPH (2013): Legjislacioni mjedisor në Kosovë 2007-2013 (Vëllimi I). Prishtinë.
4. MMPH-AKMM (2008): Raport i gjendjes së mjedisit 2006-2007. Prishtinë.
5. MMPH-AKMM –IKMN (2008): Raport i gjendjes së natyrës 2006-2007. Design House Prishtinë.
6. MMPH-AMMK (2010): Gjendja a Natyrës-Raport 2008-2009. UNDP. IN Design. Prishtinë.
7. MMPH-IHMK – Buletini Hidro-Klimatologjik 2016,
8. MMPH_IHMK – Resurset Ujore te Kosves 2015,
9. MMPH-IHMK – Vjetari Hidrometerologjik 2014,
10. Mmph-rks.org/Ligjet 15. Osmani, J. (2008): Vendbanimet e Kosovës.
11. Të dhënat nga ëeb faqja e Komunës së Prizrenit.

Shtojcë

Bashkëngjitur këtij raporti gjeni:

- Certifikata e regjistrimit të biznesit,
- Te dhënat për biznesin,
- Certifikata e pronës,
- Kopja e planit,
- Pëlqimi i komunës,
- Situacioni i terenit
- CD me raport të VNM-së
- Përshkrimi i vlerës investive

Shtojca 1. Skemat e makinerisë dhe procesit teknologjik të bazës së betonit.

